

Fillimi > -Kronikë

Dyshohet se kreu marrëdhënie seksuale me një të mitur, arrestohet 65-vjeçari në Lushnje, në banesën e tij u gjetën...

13 Janar, 2023 16:15



Madhësia e tekstit: - +

Një person ka rënë në pranga dhe një tjetër është proceduar penalisht për vepra të ndryshme penale.

Uniformat blu bëjnë me dije se është arrestuar 65-vjeçari Xh.V., pasi dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me një të mitur.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e marrë me qira nga ky shtetas, në Lushnjë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 krehëra arme zjarri dhe municion luftarak.

“Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lushnjë arrestuan në flagrancë shtetasin Xh. V., 65 vjeç, banues në Berat, pasi dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me një shtetase të mitur.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e marrë me qira nga ky shtetas, në Lushnjë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 krehëra arme zjarri dhe municion luftarak”, thuhet në njoftimin e policisë.

Gjithashtu bëhet me dije se është proceduar në gjendje të lirë F. T., 55 vjeç, banues në Berat, pasi gjatë kontrollit në automjetin që drejtonte ky shtetas, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një send të fortë (shkop bejsbolli).

Njoftimi i plotë:

DVP Fier/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lushnjë arrestuan në flagrancë shtetasin Xh. V., 65 vjeç, banues në Berat, pasi dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me një shtetase të mitur.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e marrë me qira nga ky shtetas, në Lushnjë, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 krehëra arme zjarri dhe municion luftarak.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të DVP Fier referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin F. T., 55 vjeç, banues në Berat, pasi gjatë kontrollit në automjetin që drejtonte ky shtetas, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një send të fortë (shkop bejsbolli).

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: fier

TË NGJASHME

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

WonderPatch | Sponsored

Work From Home Jobs | Search Now | Sponsored

Balluku pyetet për 400 mijë eurot e grabitura në banesën e ish-këshilltares në Kryeministri: Mua s'më del koha për...

balkanweb.com

Belly Fat Removal | Search Ads | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

KATEGORIA VIDEO

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023

14 Janar, 2023